



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Komunikimi me median nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar

Përgjigjet për gazetarin Arsen Rusta – Shqiptarja.com, Report TV

1. Sa është nr. i kërkesave të përcjella nga policia në kuadër të OFL të cilat GJKKO i kanë kthyer mbrapsht apo rëzuar si të pabazuara në ligj ?

Përgjigje : Kërkesat bazuar në Aktin Normativ nr. 1 në Gjykatën e Posaçmë të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme. Deri më tashmë janë paraqitur 43 kërkesa për sekuestrim pasurie.

Nga këto 40 kërkesa janë pranur ndërsa 3 të tjera janë në shqyrtim e sipër.

Nuk kemi patur raste të refuzimit të kërkesave por theksojmë se këto kanë qënë kërkesa me objekt sekuestrimin e pasurive.

Deri më tashmë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për konfiskim pasurie.

2. Sa prej trupës gjyqsore ju bashkuan kërkesës së Kuvendit për të kontribuar me pagën e tyre në lidhje me pandeminë COVIC 19 ?

Përgjigje : Në lidhje me këtë kërkesë të Kuvendit gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar e kanë trajtuar secili sipas vullnetit të tyre dhe nisur nga parimi i humanizmit dhe i mbrotjes së të dhënave personale për këtë çështje ne kemi menduar të mos e bëjmë publike.

3. Sa seanca janë zhvilluar me vidiokonferencë. A është një praktikë që dha rezultat apo u refuazua nga palët ?

Përgjigje : Me vidiokonferencë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë zhvilluar 5 seanca gjyqsore.

Në rastet e tjera të pandehurit kanë kërkuar të jenë të pranishëm në senacë ose kanë refuzuar zhvillimin e tyre për shkak të fatkeqsisë natyrore në bazë të së drejtës që u jep Akti Normativ Aktit Normativ nr. 9 datë 25.03.2020,

Seancat gjyqësore të zhvilluara në periudhën 10 Mars- 30 Prill pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Masa sigurimi	Kërkesa në hetime paraprake	Seanca paraprake	Seanca të çështjeve të themelit	Konfiskimet	Seanca me videokonferencë
15 seanca gjyqësore	104 seanca gjyqësore	21 seanca gjyqësore	37 seanca gjyqësore	2 seanca gjyqësore	5seanca gjyqësore

4. A ka në trupën gjyqësore deri tani të prekur nga Covid 19, ju është ofruar nga institucionet bërja e testit nga institucionet shtetërore a keni kërkuar dicka të tillë ?

Përgjigje : Në Gjykatën e Posacmë të Shkallës së Për për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe atë të Apelit nuk ka të persona të prekur nga COVID 19.

Nga ana e Insitutit të Shëndetit Publik është ofruar mundësia për bërjen e testit dhe ne jemi lidhur me këtë institucion.

Është kryer testimi për një nga gjyqtarët e Gjaktës së Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe rezultati i testimit ka rezultuar negativ.

Nuk ka patur kërkesa të tjera nga gjyqtarë ose pjesëtarë të stafit adminsitrativ.

5. Cili është apo janë ndryshimet që këni pësuar si trupë gjyqësore, vec emrit nga krimet e rënda në GJKKO ?

Përgjigje : Me Vendimin nr. 21 datë 23.01.2020 të Këshillit të Gjykatës së Posacme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar është bërë ndarja e gjyqtarëve të kësaj gjkyate në trupa gjykues sipas parashimeve të nenit 23/4, 28, 29 të ligjit nr. 9872016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”.

Ky Vendim që pasqyron ndarjen përkatse të gjyqtarëve gjendet në faqen ëeb të Gjykatës ëëë.gjp.gov.al

Përgjigjet e pyetjeve për gazetaren Anila Hoxha – Top Channel

1. Gjatë pandemisë Covid 19 për sa të paraburgosur është vendosur dërgimi i tyre në shtëpi ? Mbi cilat argumente kryesisht u është ndryshuar masa e sigurimit këtyre shtetasve ?

Përgjigje: Gjatë perisuhës së pandemisë COVID 19 është vendosur ndryshimi i masës së sigurisë nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi “ për 20 të paraburgosur. Kryesisht kjo është vendosur pasi është konstatuar gjendja e rënduar shëndetsore e tyre dhe moshën e madhe.

2. Deri diku GJKKO ka “strehuar” prokurorët e posacëm të SPAK derisa të ristrukturohen zyrat e tyre por edhe të BKH. A ka sjellë kjo vështirësi kjo zhvendosje e përkohshme ?

Përgjigje: Kërkesa për lirimin e disa ambinateve të GJKKO për llogari të Prokurorisë së Posacmë është kërkuar nga Ministria e Drejtësisë për llogari të projektit të rikonstruksionit të ambinateve ku do zhvillojnë veprimtarinë SPAK dhe BKH.

Nga ana e Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë janë liruuar disa ambiente në një aneks të godinës në katin e 2 të saj, ku ndodheshin zyrat e administratës gjyqsore. Kjo zhvendosje e përkohshme nuk ka sjellë vështirësi për Gjykatën pasi për momentin ambinetet e tjera janë të mjaftueshme por ka sjellë nevojën e sigurimit të kushteve më të mira për rregull, siuguri emasa profilaktike për të dy institucionet.

3. Nga shkrirja e Gjykatës së Krimeve të Rënda, dhe nisja e punës së GJKKO a ka gjyqtarë dhe prokurorë që janë marrë në ruajtje fizike për shkak të kërcënimeve.

Përgjigje: Nga nisja e funksionimit të GJKKO në datën 19 janar 2020 ka patur vetëm një kërkesë të një gjyqtari për vëninë nën ruajtje të posacmë, kërkesë të cilën Komisioni për Mbrojtjen e Gjyqtarëve pranë KLGJ, nuk e ka vlerësuar si të tillë. Kërkesa të tjera nuk ka patur gjatë kësaj periudhe.